



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDIM
(PROJEKT)

(Nr. __, datë ____ 2019)

“PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT
TË MINISTRAVE NR. 686, DATË 29.7.2015 ‘PËR MIRATIMIN E
RREGULLAVE, TË PËRGJEGJËSIVE E TË AFATEVE PËR
ZHVILLIMIN E PROCEDURËS SË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË
MJEDIS (VNM) DHE PROCEDURËS SË TRANSFERIMIT TË VENDIMIT
E DEKLARATËS MJEDISORE’”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 7, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit përgjegjës për mjedisin, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 686, datë 29.7.2015, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- I. Në gjithë përmbajtjen e vendimit fjala “..me shkrim” zëvendësohet me togëfjalëshin “..nëpërmjet sistemit elektronik”
- II. Në Kreun I, bëhen ndryshimet si vijon:
 1. Paragrafi i fundit në pikën 1.2 ndryshon si vijon:
“Raporti i paraprak i VNM-së të jetë i nënshkruar elektronikisht nga personi i pajisur me certifikatën e ekspertit për vlerësimin e ndikimit në mjedis, ekspertizën mjedisore dhe auditimin mjedisor nga ministri.”
 2. Pika 2 shfuqizohet.
 3. Gërma “b” e pikës 4, ndryshon si vijon:
“b) dërgon për mendim/konsultim aplikimin, nëpërmjet sistemit elektronik, institucioneve të mëposhtme, të cilët shprehen brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike.”
 4. Pika 5 ndryshon si vijon:

“ARM-ja, brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga data e marrjes së aplikimit nga AKM-ja, e dërgon për mendim nëpërmjet sistemit elektronik tek njësia/të e vetqeverisjes vendore ku propozohet projekti, të cilat shprehen, brenda 6 (gjashtë) ditëve kalendarike nga marrja e aplikimit”.

III. Në Kreun II, bëhen ndryshimet si vijon:

1. Pika 2 shfuqizohet.
2. Gërma “b” e pikës 4, ndryshon si vijon:
“b) u dërgon për mendim/konsultim aplikimin, nëpërmjet sistemit elektronik, institucioneve të mëposhtme, të cilët shprehen brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike:”
3. Pika 5 ndryshon si vijon:
“ARM-ja, brenda 2 (dy) ditëve kalendarike nga data e marrjes së aplikimit nga AKM-ja, e dërgon për mendim nëpërmjet sistemit elektronik tek njësia/të e vetqeverisjes vendore ku propozohet projekti, të cilat shprehen brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga marrja e aplikimit.”
4. Pika 10 ndryshon si vijon:
“Për t’u pajisur me Deklaratën Mjedisore zhvilluesi aplikon pranë Ministrisë nëpërmjet sistemit elektronik dhe plotëson dokumentacionin e mëposhtëm:”

IV. Kreu III, ndryshon si vijon:

1. Kur zhvilluesi ndryshon pasi ka përfunduar procedura paraprake e VNM-së, zhvilluesi i ri paraqet pranë AKM-së, në sistemin elektronik për vlerësimin e ndikimit në mjedis, nëpërmjet portalit e-Albania, kërkesën për transferimin e Vendimit për VNM paraprake, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a. Vendimin ekzistues;
 - b. Aktin/kontratën për transferimin e veprimtarisë nga zhvilluesi ekzistues tek zhvilluesi i ri;
 - c. Raport mbi zbatimin e kushteve të Vendimit për VNM paraprake, nga koha e pajisjes me Vendim, deri në momentin kur kryhet kërkesa për ërimin e tij.
2. Transferimi i vendimit për procedure paraprake të VNM-së bëhet me urdhër të titullarit të AKM-së. Urdhri i transferimit i përcillet zhvilluesit të ri, nëpërmjet sistemit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së kërkesës.
3. Kur zhvilluesi ndryshon, pasi ka përfunduar procedura e thelluar e VNM-së, zhvilluesi i ri paraqet pranë Ministrisë, në sistemin elektronik për vlerësimin e ndikimit në mjedis, nëpërmjet portalit e-Albania, kërkesën për transferimin e Deklaratës Mjedisore, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a. Deklaratën Mjedisore ekzistuese;

- b. Aktin/kontratën për transferimin e veprimtarisë nga zhvilluesi ekzistues tek zhvilluesi i ri;
 - c. Raport mbi zbatimin e kushteve të Deklaratës Mjedisore, nga koha e pajisjes me Deklaratën Mjedisore, deri në momentin kur kryhet kërkesa për ërimin e saj.
4. Transferimi i Deklaratës Mjedisore bëhet me urdhër të ministrit. Urdhri i transferimit i përcillet zhvilluesit të ri, nëpërmjet sistemit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së kërkesës.

V. Pas Kreut IV, shtohet Kreu IV/1 me këtë përmbajtje:

“Kreu IV/1

Dispozita tranzitore

1. Nga data 1 dhjetor 2019 fillon aplikimi online në portalin e-Albania për vlerësimin e ndikimit në mjedis.
2. Kërkesat për procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis, gjatë periudhës 1 dhjetor 2019 – 28 shkurt 2020 dorëzohen edhe në formë shkresore pranë ministrisë përgjegjëse për Mjedisin, deri në funksionimin e plotë të sistemit elektronik të vlerësimit të ndikimit në mjedis.
3. Pranimi, shqyrtimi i kërkesave për procesin e VNM-së, lëshimi i të gjitha dokumentave si dhe ndërveprimi institucional nga data 1 mars 2020, kryhet vetëm nëpërmjet sistemit elektronik të vlerësimit të ndikimit në mjedis.
4. Kërkesat e dorëzuara në formë shkresore deri në datën 28 shkurt 2020, shqyrtohen nga ministria përgjegjëse për mjedisin në formën e paraqitur. Nga data 1 mars 2020 ministria përgjegjëse për mjedisin nuk pranon dhe shqyrton kërkesa në formë shkresore.
5. Ministria përgjegjëse për Mjedisin, Agjencia Kombëtare e Mjedisit si dhe të gjitha instucionet përgjegjëse për vlerësimin e ndikimit në mjedis marrin të gjitha masat që, brenda datës 1 dhjetor 2019, të dorëzojnë pranë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit të gjithë të dhënat dhe bazën materiale të nevojshme për pajisjen e nëpunësve, të përfshirë në procesin e shqyrtimit të kërkesave për VNM-në, me kredencialet për aksesimin e sistemit, si dhe me nënshkrim elektronik, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
6. Ministria përgjegjëse për Mjedisin dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit marrin të gjitha masat që, brenda datës 1 dhjetor 2019 të trajtojnë nëpunësit, të caktuar si përdorues të sistemit elektronik të vlerësimit të ndikimit në mjedis.
7. Ngarkohen Ministria përgjegjëse për Mjedisin, Agjencia Kombëtare e Mjedisit si dhe Agjencia Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi”.

VI. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet juridike nga data 1 dhjetor 2019.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

RELACION

PËR PROJEKTVENDIMIN

“PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 686, DATË 29.7.2015 ‘PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE, TË PËRGJEGJËSIVE E TË AFATEVE PËR ZHVILLIMIN E PROCEDURËS SË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS (VNM) DHE PROCEDURËS SË TRANSFERIMIT TË VENDIMIT E DEKLARATËS MJEDISORE’”, TË NDRYSHUAR

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i projektvendimit është që të lehtësojnë personat fizik/juridik nga procedurat administrative lidhur me mënyrën e aplikimit dhe zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore. Aplikimet për procesin e VNM-së do të kryhen nëpërmjet sistemit elektronik të vlerësimit të ndikimit në mjedis, në portalin e-Albania. Nëpërmjet këtij sistemi shmanget kontakti i qytetarëve dhe bizneseve me institucionet shtetërore si dhe shmangen pritjet nëpër zyrat e këtyre institucioneve. Aplikuesit do të marrin përgjigje në kohë reale nëpërmjet komunikimit elektronik. Ky sistem do të dokumentojë dhe do të arkivojë gjithë procesin duke rritur kështu efikasitetin në komunikim lidhur me parregullsitë/mungesën e dokumentacionit që në momentin fillestar të aplikimit.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Rishikimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave të sipërcituar bëhet në kuadër të paketës antikorrupsion, rritjes së transparencë në fushën e mjedisit, si dhe në

përputhje me Reformën e Derregullimit dhe nuk është parashikuar në programin analitik të akteve për vitin 2019, pasi është një nisëm e ndërmarrë së fundmi në kuadër të ndalimit të informalitetit dhe korrupsionit.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Miratimi i këtij projektvendimi do të mundësojë që, personat fizik/juridik të kenë një procedurë më të thjeshtuar lidhur me mënyrën e aplikimit të procesit të VNM-së. Aplikimi do të kryhet nëpërmjet sistemit elektronik në portalin e-Albania, duke qenë se aktualisht ky proces kryhet nëpërmjet dorëzimit të dosjeve voluminoze pranë ministrisë, e cila i sjell qytetarëve dhe subjekteve humbje kohe dhe kosto për administrimin e tyre.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBETAR

Rishikimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave të sipërcituar bëhet në përputhje me programin e Qeverisë për të luftuar informalitetin dhe korrupsionin, e cila është një nismë për të thjeshtuar procedurat administrative për shërbimet e ofruara ndaj personave fizik/juridik dhe për rrjedhojë për të ulur korrupsionin.

Projektvendimi është në përputhje me nenin 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 7, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", të ndryshuar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Relacion per Projektvendimin "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e këshillit të ministrave nr. 686, datë 29.7.2015 'për miratimin e rregullave, të përgjegjësisve e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (vnm) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore'", të ndryshuar

Ndryshimet e propozuara në projekt aktin nuk transpozojnë akte të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Për të lehtësuar kuptimin e këtij projektvendimi sqarojmë se parimet e procedurës dhe institucionet përgjegjëse, si dhe projektet që janë objekt i vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) janë përcaktuar e miratuar në ligjin 10440, datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar. Ky projektvendim synon të përcaktojë vetëm procedurën që ndiqet për realizimin e procesit të VNM-së nëpërmjet sistemit elektronik e-Albania.

Në të gjithë përmbajtjen e projektvendimit fjala "...me shkrim" zëvendësohet me togëfjalëshin "...nëpërmjet sistemit elektronik".

Në Kreun I janë bërë ndryshime në pikat 1.2, në gërmën 'b' të pikës 4 si dhe ndryshon pika 5. Shfuqizohet pika 2 e këtij kreu.

Ndryshon në kreun II, gërma 'b' e pikës 4, si dhe pikat 5 dhe 10. Pika 2 shfuqizohet.

Kreu III, ka përcaktuar procedurën për transferimin e vendimit apo të deklaratës mjedisore nëpërmjet sistemit elektronik e-Albania. Gjithashtu, është shtuar si dokumentacion kërkues raporti mbi zbatimin e kushteve të Vendimit për VNM praprake apo pajisjes me Deklaratë Mjedisore, nga koha e pajisjes me Vendim/ Deklaratë Mjedisore, deri në momentin kur kryhet kërkesa për transferimin e tij.

Shtohet kreu IV/I me përmbajtje dispozita tranzitore.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi dhe Agjencia Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.

Relacion per Projektvendimin "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e këshillit të ministrave nr. 686, datë 29.7.2015 'për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (vnm) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore"', të ndryshuar

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA
QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektvendim do të dërgohet për mendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe në Ministrinë e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Agjencinë Kombëtare Shtetërore të Informacionit dhe Agjencisë për Mbështetjen e Vetqeverisjes Vendore.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE
SHPENZIMEVE BUXHETORE

Zbatimi i projektvendimit nuk ka efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit, pasi të gjitha shpenzimet mbulohen nga kërkuesi.

 **MINISTRI**
Blendi Klosi